

V E N D I M
Nr. 103, datë 23.5.2002

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Kristofor Peçi	Anëtar i Gjykatës Kushtetuese
Petrit Plloçi	Anëtar i ““
Alfred Karamuço	Anëtar i ““

më datë 23.5.2002, mori në shqyrtim paraprak kërkesën me nr.114 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: Fatos Hamiti

O B J E K T I: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.173, datë 3.5.2002 të Këshillit të Ministrave “Për lirim dhe emërim në detyrë”.

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, pasi shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Kërkuesi Fatos Hamiti ka qenë Prefekt në Prefekturën e Vlorës dhe me vendimin nr.173, datë 3.5.2002, Këshilli i Ministrave e ka shkarkuar nga detyra. Ndaj këtij vendimi ai është ankuar në Gjykatën Kushtetuese, duke kërkuar shfuqizimin si antikushtetues të tij.

Kolegji vëren se shqyrtimi i largimit nga detyra e kërkuesit nuk është në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese. Në bazë të nenit 115 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese shqyrton ankesat e organeve të zgjedhura drejtpërdrejt të njësisë së qeverisjes vendore kur ato shpërndahen ose shkarkohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Prefekti nuk hyn në kategorinë e këtyre organeve. Ai, në bazë të nenit 114 të Kushtetutës, është përfaqësues i Këshillit të Ministrave në qarkun përkatës e jo organ i zgjedhur drejtpërdrejt i qeverisjes vendore.

Në këto kushte, kërkesa nuk mund të pranohet për të kaluar në seancë plenare për shkak të mungesës së kompetencës.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 31/3 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes në seancë plenare.